



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2022:055034

Datë: 06.02.2023

Numri i dokumentit: 03943497

PPP.nr.309/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit E. Q., kundër debitorit Radio Televizioni i Kosovës (RTK), me seli në Prishtinë, rruga "...", nr...., për pagesën e borxhit në vlerë prej 32,000.00 €, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të parashtruar kundër urdhrit mbi caktimin e përmbarimit P.nr.22/22, i datës 11.02.2022, të përmbaruesit privat I. I. si organ përmbarues, jashtë seancës me datë 26.01.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Radio Televizioni i Kosovës (RTK), me seli në Prishtinë, rruga "...", nr.... dhe SHFUQIZOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.22/22, i datës 11.02.2022, në shumën prej 32,000.00 €, i lëshuar nga përmbaruesi privat I. I., si organ përmbarues.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat I. I., si organ përmbartues, me urdhrin P.nr.22/22, i datës 11.02.2022, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturave nr.10-061, e datës 30.10.2015, fatura nr.11-065 e datës 30.11.2015, fatura nr.12-090 e datës 31.12.2015, fatura nr.1-037 e datës 31.01.2016, fatura nr.3-049 e datës 31.03.2016, fatura nr.4-050 e datës 30.04.2016, fatura nr.5-060 e datës 01.05.2016 dhe fatura nr.02 e datës 02.11.2016, të lëshuara nga kreditori E. Q., të cilat sipas nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje referuar si: LPP) paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ndërsa në bazë të nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të këtij ligji paraqesin dokument të besueshëm.

Kundër urdhrin për përmbartim P.nr.22/22, i datës 11.02.2022, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim debitori, me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është marrë vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, dhe se kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin kundër debitorit. Më tej ka theksuar se debitori ka nënshkruar kontratë mbi bashkëpunimin programor me N.SH. Q. M. “M. – Kosovë”, lidhur me emisionin “P. Rr.”, ndërsa në inicimin e procedurës përmbartimore janë të shënuara të dhënat personale të znj. E. Q., në cilësinë e kreditores, e jo të dhënat e N. Sh. Q. M. “M. – Kosovë”, me të cilën debitori ka nënshkruar kontratë, pra, pa mëdyshje këtë procedurë nuk e ka iniciuar personi i autorizuar/përfaqësuesi i N.SH. Q. M. “M. – Kosovë”. Në fund i ka propozuar gjykatës që ta pranojë si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ta anulojë Urdhrin për Përmbartim P.nr.22/22, të datës 11.02.2022.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e ushtruar nga debitori, duke theksuar se sa i përket pretendimeve të debitorit se dokumenti në bazë të të cilit është nxjerrë urdhri përmbartues nuk paraqet dokument të besueshëm, ka theksuar se propozimit për përmbartim i janë

bashkangjitur faturat e vërtetuara tek noteri, që sipas LPP-së paraqesin dokument të besueshëm. Ndërsa sa i përket pretendimit se kreditori në fjalë nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin, duhet cekur se kreditori E. Q. ka qenë udhëheqëse/drejtoreshë e N.SH. Q. M. “M. – Kosovë”, dhe si e tillë e ka nënshkruar kontratën me debitorin RTK. Në fund ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.22/22 i datës 11.02.2022.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të pasqyruara në prapësimin e paraqitur, propozimit për përmbarim, si dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundimin se prapësimi i debitorit është i bazuar.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv në këtë aktvendimi duke u bazuar të nenin 21 të LPP-së, sipas së cilit përcaktohet se “Organi Përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit të besueshëm (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa, sipas nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 i LPP-së, përcaktohet faturat paraqesin dokument të besueshëm . Kurse, neni 29 paragrafi 3 i LPP-së përcakton se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim, po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit financiar”. Kurse, me nenin 43, paragrafi 4 i LPP-së është përcaktuar se: “Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.

Gjykata, pasi analizoi në tërësi dokumentin e besueshëm, përkatësisht faturën nr.10-061, e datës 30.10.2015, fatura nr.11-065 e datës 30.11.2015, fatura nr.12-090 e datës 31.12.2015, fatura nr.1-037 e datës 31.01.2016, fatura nr.3-049 e datës 31.03.2016, fatura nr.4-050 e datës 30.04.2016, fatura nr.5-060 e datës 01.05.2016 dhe fatura nr.02 e datës 02.11.2016, vërejtë se propozimi për përmbardim është lejuar në shumën prej 32,000.00 €. Në rastin konkret prapësimi i debitori duhet të aprovohet si i bazuar dhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata ka marr këtë vendim, pas konstatimit se dokumenti i besueshëm, përkatësisht fatura nr.10-061, e datës 30.10.2015, fatura nr.11-065 e datës 30.11.2015, fatura nr.12-090 e datës 31.12.2015, fatura nr.1-037 e datës 31.01.2016, fatura nr.3-049 e datës 31.03.2016, fatura nr.4-050 e datës 30.04.2016, fatura nr.5-060 e datës 01.05.2016 dhe fatura nr.02 e datës 02.11.2016, në vlerën prej 32,000.00 €, në bazë të së cilave në petitumin e propozimit për përmbardim është kërkuar nga kreditori që të caktohet përmbardimi, dhe të detyrohet debitori t'ia paguaj kreditorit shumën e cekur më lartë, nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbardimit ashtu siç është përcaktuar me nenin 21 dhe 29 paragrafi 1 pika 1.3 dhe paragrafi 3.

Rrjedhimisht, gjykata vlerësoj se kreditori me asnjë provë nuk ka mundur ta provoj faktin që fatura nr.10-061, e datës 30.10.2015, fatura nr.11-065 e datës 30.11.2015, fatura nr.12-090 e datës 31.12.2015, fatura nr.1-037 e datës 31.01.2016, fatura nr.3-049 e datës 31.03.2016, fatura nr.4-050 e datës 30.04.2016, fatura nr.5-060 e datës 01.05.2016 dhe fatura nr.02 e datës 02.11.2016, në bazë të së cilave është caktuar përmbardimi, i është dorëzuar debitorit. Kjo për faktin se faturat nuk janë nënshkruar dhe pranuar nga ana e debitorit, dhe si pasojë e kësaj debitori si në hyrje, nuk mund ta ketë cilësinë e debitorit, nëse në fatura është shkruar emri dhe mbiemri, por nuk është nënshkruar nga personi - subjekti me emër dhe mbiemër (firma) si në faturë, dhe po ashtu faturat nuk e përmbajnë kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, dhe si të tilla nuk mund të kenë cilësi në këtë procedurë, dhe se nuk ka afuar asnjë dëshmi - dokument për t'i bërë të besueshme

pretendimet e tij dhe që do të ndikonte që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur si në dispozitiv.

Mbi bazën e asaj që u tha më lart, dhe në bazë të nenin 73 paragrafi të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.309/2022, datë 26.01.2023

Gjyqtari

Përparim Zeka

### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.